



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RREGULLORJA E PUNËS SË KUVENDIT TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

Prishtinë, maj 2010

Në bazë të nenit 4 pika 4.14.1 të Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, të dt. 30.06.2010 , Kuvendi i Asociacionit të Komunave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2010 miratoi;

RR E G U L L O R E N
E
PUNËS SË KUVENDIT TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra, udhëheqja dhe funksionimi i punës së Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës në tekstin e mëtejme (Asociacioni)

Përkufizimi

Neni 2

Përkufizimet në këtë Rregullore:

- a) Statut- nënkupton aktin më të lartë juridik të miratuar me shumicën e anëtarëve nga Kuvendi i Asociacionit;
- b) Kuvendi – nënkupton organin më të lartë të qeverisjes së Asociacionit i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e Asociacionit ;
- c) Këshilli – nënkupton , kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës të zgjedhur me votën e lirë të qytetarëve ;
- d) Bordi i Asociacionit – nënkupton organin e udhëheqjes së Asociacionit të përbërë nga shtatë (7) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Asociacionit;
- e) Kryetari i Asociacionit - nënkupton kryetarin e Bordit i zgjedhur nga Kuvendi i Asociacionit për Kryetar dhe i cili e përfaqëson Asociacionin para organeve shtetërore dhe organeve tjera;
- f) Anëtar i Kuvendit – është kryetari i komunës dhe delegati i komunës përkatëse;
- g) Kuvendi komunal – nënkupton organin më të lartë në Komunë, i përbërë nga anëtarët e zgjedhur drejtpërdrejtë nga votat e qytetarëve ;
- h) Kryetari i Komunës – nënkupton kryetarin e zgjedhur drejtpërdrejtë nga votuesit që kanë drejtë vote në komunë, në përputhje me ligjin;

II. MBAJTJA E MBLEDHJEVE TË KUVENDIT

Neni 3

Mbledhjet dhe kuorumi

1. Kryetari i Asociacioni i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Asociacionit;
2. Kryetari i Asociacionit në pajtim me Statutin e Asociacionit mund të thërras mbledhje të jashtëzakonshme në çdo kohë ;
3. Në mungesë të Kryetarit, mbledhjen e kryeson nënkryetari, e në mungesë të nënkryetarit mbledhjen e kryeson njeri nga anëtarët e Bordit;
4. Vendi i mbajtjes, data dhe rendi i ditës do të do të shpallen më së largu një (1) muaj para mbajtjes së mbledhjes. Ftesa dhe materiali për mbledhje do t'u dorëzohen anëtarëve të Kuvendit, jo më vonë se një (1) javë para mbledhjes ;
5. Mbledhjet e paparapara (të jashtëzakonshme) të Kuvendit mund të thirren së paku një muaj pas paralajmërimit dhe kur për këtë e kanë dhënë pëlqimin 2/3 e anëtarëve të kuvendit;
6. Për çdo mbledhje të Kuvendit mbahet procesverbali. Procesverbali përmban emrat e anëtarëve të pranishëm, rendin e ditës, çështjet të cilat do të diskutohen, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo refuzuara. Nëse kërkohet të thirret emri i secilit anëtar, në procesverbal duhet të shënohet si ka votuar secili. Procesverbalin e mban personi administrativ i Asociacionit dhe ekstrakti i procesverbalit miratohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Asociacionit. Secili nga anëtarët ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.
7. Secili anëtar që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit duhet të shënohet në listën e pjesëmarrësve, të parapare për këtë qëllim;
8. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme nëse merren me shumicën e thjeshtë të votave nga anëtarëve prezent dhe votimi bëhet në mënyrë të hapur.
9. Kuvendi i Asociacionit trajton vetëm çështjet që janë në kompetencë të Kuvendit të Asociacionit.
10. Asnjë nga pikat e propozuara të rendit të ditës nuk do të shtrohen për diskutim në mbledhje, nëse nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 4

Rendi i ditës në mbledhje

Rendi i ditës në mbledhje të asociacionit do të jetë:

- a) miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit;

- b) njoftimet e Kryesuesit;
- c) të paraqes çështjen (nëse ka ndonjë) të mbetur nga mbledhja e kaluar;
- d) të pranoj dhe shqyrtoj raportet apo procesverbalet e Bordit, komisioneve dhe kolegjiuemeve;
- e) të shqyrtojë propozimet për votime ;
- f) të përfundojë çështjet tjera në rendin e ditës;
- g) kryesuesi mund të ndryshojë radhitjen e çështjeve në rendin e ditës në mbledhje dhe t'i njoftoj lidhur me të, anëtarët e Kuvendit të Asociacionit;
- h) rendi i ditës i propozuar nga Kryetari i Asociacionit, miratohet nga Kuvendi;

Neni 5

Rregullat e diskutimit

1. Nuk mund të diskutohet asnjë pikë para se të shtrohet si propozim për diskutim në mbledhje;
2. Kur bëhen ndryshime, propozimi i ndryshuar zë vendin e propozimit të parë dhe shndërrohet në propozim të rregullt në të cilin mund të propozohen ndryshime të tjera;
3. Nëse dy ose më shumë anëtar të Kuvendit dëshirojnë të marrin fjalën, Kryetari i Asociacionit vendos për renditjen e diskutimit. Anëtarët e Kuvendit i drejtohen Kryetari të Asociacionit dhe gjatë diskutimit të tyre duhet t'u përmbahen çështjeve të diskutuara në mbledhje;
4. Anëtarët e Kuvendit mund të kërkojnë ta marrin fjalën sipas renditjes ose sipas shpjegimeve personale dhe diskutimi i tyre duhet të dëgjohet. Vendimi i kryetarit mbi pikat e renditura ose mbi pranimin e shpjegimeve personale është vendimtar;
5. Kryetari në mbledhje nuk lejon asnjë propozim deri sa të gjithë ata që dëshirojnë të diskutojnë ta kenë bërë këtë për kohë të mjaftueshme;
6. Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet dhënia e propozimeve tjera, përveç:
 - a) ndryshimeve;
 - b) propozimit të dhënë për të parandaluar çrregullimet;
 - c) propozimit për të përjashtuar publikun dhe mjetet e informimit ;
 - d) propozimit për të kaluar në pikën me radhë të rendit të ditës;
 - e) propozimit i cili kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit ;
 - f) propozimit për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e radhës;
 - g) propozimit për ndërprerjen e mbledhjes;
7. Kur një anëtar i Kuvendit e merr fjalën në mbledhje të gjithë anëtarët tjerë pjesëmarrës qëndrojnë ulur;

8. Nëse ndonjë anëtar jep ndonjë propozim, ai ka të drejtë të marrë përgjigjen menjëherë, para se propozimi t'i nënshtrohet votimit;
9. Gjatë kohëzgjatjes së mbledhjes, kryesuesi duhet të respektojë që të gjithë anëtarët pjesëmarrës me të drejtë diskutimi, të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje. Anëtarëve të Kuvendit u lejohet të diskutojnë deri në pesë (5) minuta për çështjen që diskutohet. Nëse në diskutim paraprak përmendet me emër ndonjë anëtar i Kuvendit, ai ka të drejtë të replikojë, një herë, por jo në kohëzgjatje më shumë se dy (2) minuta.

Votimi

Neni 6

1. Votimi në të gjitha mbledhjet bëhet me ngritjen e dorës;
2. Para votimit, secili anëtar i Kuvendit ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen ;
3. Në raste të veçanta, anëtari i Kuvendit mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes se si, ai/ajo ka votuar për çështjen e caktuar.
4. Kur ka nevojë të bëhet votimi i propozimit për zgjedhjen e ndonjë anëtari për ndonjë pozitë ose kur ekzistojnë më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve paraqiten sipas radhitjes alfabetike të emrave të tyre ;
5. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit secili anëtar ka nga një votë. Në Kuvendin e punës Kryetari i Asociacionit ka votë shtesë, në rast të numrit të njëjtë të votave "për " ose " kundër" ndonjë propozimi;
6. Vendimet e Kuvendit merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve prezent në mbledhje ;

Neni 7

Kodi i mirësjelljes

1. Nëse Kryetari i Asociacionit konsideron se njëri prej anëtarëve të Kuvendit nuk silllet mirë në mbledhje, duke mos respektuar fjalën e kryesuesit, duke e penguar me dashje punën e mbledhjes ose duke bërë sjellje ofenduese, atij duhet t'i tërhiqet vërejtja. Nëse sjelljet e anëtarit të Kuvendit në fjalë vazhdojnë

të jenë të pandryshueshme, kryetari i mbledhjes mund të ndërmarrë njëri prej këtyre masave veçmas ose si varg masash si në vijim:

- a) iu propozon të pranishmëve në mbledhje që anëtari të mos dëgjohet, në të cilin rast propozimi duhet të bëhet menjëherë në mbledhje, pa nevojë për kraheje dhe nëse propozimi miratohet, anëtarit i ndalohet diskutimi i mëtejshëm në mbledhje;
 - b) e udhëzon anëtarin e Kuvendit të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime;
 - c) jep urdhrin që anëtari të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime;
 - d) e shtyn mbledhjen për një (1) orë ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë;
2. Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim, kryetari i mbledhjes mund të urdhërojë që të gjithë të lirojnë sallën e mbledhjes dhe mund të shtyjë mbledhjen për një (1) orë, ose deri në kohën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë.

III. PROCEDURAT E NDRYSHIMIT

Neni 8

Procedurat e ndryshimit të Rregullores së punës duhet të jenë si në vijim:

- a) Çdo propozim për ndryshimin e Rregullores së Punës duhet t'i paraqitet Kuvendit të Asociacionit;
- a. Nëse propozimi pranohet, Kuvendi do të vendos siç është paraparë me Statut të Asociacionit;

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 9

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Nr. 02/2010

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës

Bajrush Xhemali